



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KUKËS
DREJTORIA FINANCËS DHE BUXHETIT

P/VENDIM

Nr. 58 Datë 22.07.2022

PËR

MIRATIMIN E DRAFTIT TË RISHIKUAR TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2023-2025

Bazuar në ligjin Nr.139/2015, të miratuar me datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" nenet 8/2, 9/1/1.3/e, 54, ligjin Nr.44/2015, të miratuar me datë 30.04.2015 "Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë", ligjin Nr.68/2017, të miratuar me datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", nenet 7 dhe 48, ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", (i ndryshuar), udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr.2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", (i ndryshuar), Udhëzimin nr.23 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësisë të vetëqeverisjes vendore", (i ndryshuar), Udhëzimin Nr.7, datë 25.02.2022 "Për një ndryshim në udhëzimin nr.23 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësisë të vetëqeverisjes vendore", Udhëzimin Nr. 8, datë 28.02.2022 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2023-2025", Vendimin e Këshillit Bashkiak Kukës Nr.73 datë 24.12.2021 "Për miratimin e Kalendarit të aktiviteteve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 dhe të buxhetit vjetor 2023", i propozojmë Këshillit të Bashkisë Kukës për:

MIRATIM:

I. Draftin e rishikuar të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025, bashkëngjitur këtij projekt - vendimi.

